

**Ju lutem mbushni
informacionin me poshte dhe
dergojeni te prifti**

Data qe kerkoni per sherbimin:

*Emri i plote i personit qe do te
pagezohet:*

*Emri i pagezimit (nqs eshte
ndryshe):*

Ditelindja dhe Vendlindja:

Emri i Babait:

*Emri i Nenes (me mbiemrin e
lindjes):*

Adresa:

Nr. i Telefonit:

E-mail:

Emri i Nunit:

Emri i Nunes:

Adresa:

Nr. i Telefonit:

E-mail:




St. Nicholas Albanian Orthodox Church
181-14 Midland Parkway
Jamaica Estates, NY 11432
(718)380-5684

**Perkthyer:
Olsi Argjendari**

PAGEZIMI

Hyre ne Kiske



*Sa u pagezuat me Krishtin
me Krishtin u veshte.*

Duke iu bindur dhe imituar Krishtin, Krishteret Ortodoks i bashkohen trupit te kishes nepermjet kungates se shenjte te pagezimit. Uji i shenjte i pagezimit eshte nje simbol i vdekjes tone por ne te njejten kohe eshte shpresa ne Ringjalljen e Krishtit- Perendia jone i cili eshte ringjallur. Edhe pse ky akt mund te shihet vetem si nje zakon, eshte sigurisht me shume se aq. Pagezimi eshte nje orientim i ri ne jeten e nje personi, duke kaluar nga jeta e tij ose e saj qe ne lindje ne nje jete krishtere e cila ben te mundur shpetimin.

Duke qene nje akt i tille, pagezimi kerkon sakrifice dhe angazhim. Per te rriturit kjo do te thote pjesemarrje besnike ne aktivitetet dhe veprimtarine e kishes nepermjet sherbimeve, lutjeve, kreshmave, dhe festave te saj. Per femijet, me qene se ata nuk kane mundesi t'i ndermarrin vete keto angazhime, do te thote qe pergjegjesia bie mbi prinderit dhe nunet e tyre.

Nunet jane te pergjegjshem per mireqenien shpirtore te femijeve qe ata kane pagezuar. Ne kisha kjo lidhje konsiderohet edhe me e afert sesa lidhja e gjakut. Prandaj nunet duhet te jene fetare krishtere ortodoks dhe pjesemarrës te rregullt ne veprimtarite e shenjta te kishes, sic jane rrefimi dhe kungimi.

Gjithashtu prinderit duhet te kuptojne se sjellja e femijeve te tyre ne besimin kristian do te ndryshoje prioritetin e veprimtarive te femijeve. Femijet duhet te angazhohen me pjesemarrjen e rregullt te sherbimeve te kishes dhe punes per te siguruar qe feja qe praktikohet te djelave ne kishte te praktikohet edhe ne shtepi.



Pagezimi eshte tregues i nje jete ndryshe nga ajo jetuar qe ne lindje prandaj dhe kerkon disa detyrime perpara dhe mbas kryerjes se ketij veprimi te shenjte:

- Familja duhet te programoje nje takim me priftin perpara pagezimit ne nje dite pervec te djeles ne mengjes.
- Nunet duhet te takohen me priftin perpara pagezimit.
- Te djelen perpara pagezimit familja duhet te jete prezente per nje prove te shkurter.
- Ai ose ajo qe pagezohet duhet te frekuentoje gjithë sherbimet e te djelave muajin mbas pagezimit.
- Ai ose ajo qe sapo eshte pagezuar e ka te detyrueshme te ndjeke sherbimet e kishes te pakten nje here ne muaj mbas pagezimit

Pagezimi nuk eshte nje ngjarje por nje hyrje ne jeten krishtere e cila kerkon disipline dhe konsistence. Sigurohuni qe femija juaj te mos jete krishtere vetem nga emri.

Ka disa objekte qe jane te nevojshme per pagezim. Nuk eshte e nevojshme qe keto objekte te jene me ornamente zbukurimi. Keto sende duhet t'i sjelle familja ose nunet.

- Varese kryqi
- Qiri te madh
- Shishe te vogel me vaj ulliri
- Peshqir te madh
- Veshje te bardhe per femijen

Per bekimet e kishes nuk ka kurre asnje cmim, por do te vleresohej shume kontributi juaj per mbeshtetjen e kesaj pune kaq te rendesishme. Me poshte mund te shihni disa sugjerime.

| | |
|--------------------|-------|
| Mon-Sat 9am-4pm | \$600 |
| Sunday 9am | \$400 |

Gjithashtu ju lutemi te kuni parasysh se zakonisht drejtuesit te korit dhe korit i jepen dhurata. Ne qofte se jeni te interesuar te merrni me qira katin e poshtem te kishes per te festuar pagezimin, ju lutemi te pyesni.

Ju lutemi te pyesni priftin per te caktuar daten dhe orarin e pagezimit sa me shpejt te jete e mundur dhe perpara se te ftoni rrethin familjar dhe shoqeror.